

VENDIM
Nr. 512, datë 30.8.2023

PËR NGARKIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SI ORGAN QENDROR BLERËS, PËR REALIZIMIN E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT PËR PROJEKTIDETË E ZHVILLIMIT TË *TIRANA EXPO* DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT, MIRATUAR PËR VITIN 2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), si organ qendror blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e zhvillimit të *Tirana Expo*, një hapësirë fleksibël për ekspozita, panairë, koncerte, takime, evenimente, rekreacion dhe logjistikë.
 2. Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, t’i shtohet fondi prej 23 705 000 (njëzet e tre milionë e shtatëqind e pesë mijë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”, për përballimin e shpenzimeve për realizimin e procedurave të prokurimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.
 3. Efekti financiar, prej 23 705 000 (njëzet e tre milionë e shtatëqind e pesë mijë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2023.
 4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama